



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.85/2024

Prishtinë, më 16.04.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Arjeta Fejza, Albana Bytyçi, Drita Millaku, Labinotë Demi-Murtezi, Fatmire Kollçaku dhe Marigona Geci.

Munguan: Duda Balje, Nasuf Bejta, Ariana Musliu- Shoshi dhe Eliza Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Drita Gjonbalaj-Agjencia Kosovare e Privatizimit; Hysni Mehani-GP LVV; Zelfije Zeneli- Kosovapress; Alban Bislimi-Ekonomiaonline; Natyra Salihaj-EO; Ema Krasniqi-KDI; Blerina Istrefi-GLPS; Naim Jakaj-IKD; Gent Ramosaj-GP AAK dhe Celal Ilias- Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Arjeta Fejza, nënkryetare e parë e Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit, fillimisht, para se të procedojë me rendin e ditës, shprehu ngushëllime për vrasjen e gruas në Pejë, e cila dyshohet se është vrarë nga bashkëshorti i saj. Në vijim, tha se u bëjmë thirrje institucioneve, që t'u dalin zot detyrave të tyre, sa i përket mbrojtjes së jetës së grave dhe sigurimit të mirëqenies së të gjitha të drejtave të tjera.

Gjithashtu, organet e drejtësisë të japin dënime maksimale për rastet e tilla dhe veprimtaria e tyre të intensifikohet, sepse me të vërtetë kjo është e patolerueshme.

Ajo më pas vazhdoi me procedimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 12.3.2024;
3. Diskutim në Komision, lidhur me peticionin e punëtorëve të AKP-së;
Të ftuar: përfaqësuesit e 23 punëtorëve nënshkrues.

4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Nënkryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 12.3.2024

Nënkryetarja konstatoi se Komisioni miratoi pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më datë 12 mars 2024.

3. Diskutim në Komision, lidhur me peticionin e punëtorëve të AKP-së Të ftuar: përfaqësuesit e 23 punëtorëve nënshkrues

Nënkryetarja, tha se kemi prezent znj. Bukurije Gjonbalaj, përfaqësuesen e peticionit të nënshkruar prej 23 punëtorëve të AKP-së, që i janë drejtuar Komisionit, lidhur me shqetësimet e tyre dhe fjalën ia kaloi znj. Gjonbalaj.

Drita Gjonbalaj, falënderoi Komisionin që ia ka mundësuar që të dëgjohet dhe të shprehë shqetësimin e këtyre grave, që janë punëtorë të AKP-së, e në mesin e këtyre nënshkruesve janë 21 femra dhe 2 meshkuj, që shprehin shqetësimin, lidhur me barazinë gjinore në pozitat e larta drejtuese në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Njoftoi se punon në AKP, nga fundi i vitit 2004, si zyrtare e prokurimit në Divizionin e Prokurimit në AKP.

Tha se punëtorët në AKP-së ndihen të kërcënuar nga menaxhmenti që të flasin të vërtetën, dhe, edhe pse kanë nënshkruar 23 veta peticionin, asnjëra/i, nuk morën guximin të vijnë e të flasin këtu në Parlament.

Ajo shtoi se kur ka kërkuar të drejtat e saj për avancim në detyrë dhe ka paraqitur dyshimet për keqpërdorim në procedurat e prokurimit në AKP, i janë shqiptuar dy masa disiplinore, sepse me tri vërejtje të largojnë nga puna, pra qëllimi ka qenë largimi nga puna.

Përkundër deklarimeve politike, deri tash, pak i është dhënë hapësirë femrës në Kosovë, se qysh nga fillimi i AKM-së dhe tutje AKP-së, gratë kanë pozita shumë të ulëta, prandaj konstatojmë se është bërë një diskriminim i madh në pozita të larta drejtuese.

Njoftoi se më 24 shkurt 2020, Avokati i Popullit ka dërguar letër me rekomandime përfaqësuesit të AKP-së, lidhur me zbatimin e Ligjit për barazi gjinore, përkitazi me kuotën gjinore prej 50% për secilën gjini në pozita drejtuese dhe vendimmarrëse në AKP. Më 31 gusht 2020, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga përfaqësuesi i AKP-së, përmes së cilës u informua se në të ardhmen, në konkurset për pozitat e lira të punës për nivelet drejtuese dhe vendimmarrëse, do të merren parasysh rekomandime për respektimin e kuotës së barabartë gjinore.

Në konkursin e shpallur për dy zëvendës drejtorë menaxhues, funksione mbështetëse dhe operative, kërkohet përvojë në pozita menaxheriale dhe gjithashtu kufizohet të aplikojnë vetëm personat me përvojë në pozitat drejtuese.

Më tej, tha se personalisht është penguar të marrë pozita drejtuese në të kaluarën, në mënyrë që sot të mos i plotësojë kriteret në konkurset e shpallura. Pra, AKP ka bërë dhe po vazhdon të bëjë diskriminim profesional dhe gjinor të vazhdueshëm ndaj saj dhe edhe

ndaj personave të tjerë në baza gjinore. Ajo vazhdimisht ka konkurruar nëpër konkurse në AKP për avancim në pozita dhe është me përgatitje doktor i Shkencave Ekonomike, por çdoherë është refuzuar, sikurse edhe në konkursin e fundit për dy zëvendës drejtorë menaxhues, me kinse arsyetimin se nuk ka përvojën në pozitat e larta drejtuese. Ajo shtoi se si të bëjë përvojë menaxheriale, kur përgjegjësit e AKP-së, që nga viti 2008 e kanë penguar, duke i vendosur kurthe për avancim në detyrë.

Njoftoi se ka bërë ankese në KPMSHCK dhe në gjykata, për avancim në detyrë, që nga viti 2012 dhe të gjitha ankesat i janë refuzuar. Po ashtu, ka bërë ankesë në Gjykatë Kushtetuese, që nga nëntori i vitit 2022 dhe ende gjykata nuk e ka dhënë verdiktin përfundimtar.

Më tutje, tha se gratë që punojnë në AKP, janë organizuar dhe ia kanë adresuar peticionin Bordit të Drejtorëve, me datë 8 mars 2024 dhe më 15 mars 2024, përfaqësuesit e peticionit janë ftuar në takim me krerët e Bordit të Drejtorëve, tha se kanë shpalosur brengat e tyre për diskriminim në baza gjinore në AKP dhe kanë kërkuar që të marrin masa për ta eliminuar këtë dukuri negative, që po përcillet me dekada në AKP dhe kryesuesi i bordit ka thënë se fatkeqësisht jetojmë në një botë, e cila është ndërtuar duke iu dhënë përparësi meshkujve. Ndodhemi para një dyshimi se duhet respektuar një ligj apo një parim që nuk është i tabluar mirë në ligj, tha se këto janë fjalët e kryesuesit të Bordit të AKP-së.

Është kërkesë diskriminuese për gratë, nëse shpallen konkurse dhe kërkohet përvojë menaxheriale. Këto përvoja menaxheriale i kanë fituar burrat, që në të shumtën e rasteve, i kanë fituar në mënyrë të kundërligjshme. Për këtë gjë tregon vendimi i KPMSHCK-së i vitit 2012, që atë vendim e ka edhe personeli i AKP-së, por e kanë fshehur.

Në vijim, tha se nga Komisioni parlamentar kërkon që të zbatohet vendimi i IAP-it, dhe këshilla e saj është që të bëhet hetim i mirëfilltë në AKP, se si kanë ndodhur punësimet dhe gradimet, që nga viti 2008 dhe si i kanë fituar njerëzit këto pozita drejtuese, dhe ta detyrojnë bordin dhe menaxhmentin e AKP-së, që të respektojnë ligjet në fuqi dhe të drejtat e njeriut.

Në vazhdim, ajo prezantoi edhe numrin e punëtorëve të punësuar në AKP, duke pasqyruar edhe me numra, sa i përket raportit gjinor, si në nivele drejtuese, menaxheriale, nivele me të ulëta etj.

Nënkryetarja theksoi se me sa u kuptua, në AKP paska ndodhur një diskriminim i vazhdueshëm, ashtu sikur kur ka pasur konkurse, por edhe emërim brenda agjencisë.

Drita Gjonbalaj, tha se edhe për momentin, janë të emëruar nga bordi dy zëvendës drejtorët.

Albana Bytyçi, fillimisht shprehu ngushëllime, lidhur me vrasjen e një gruaje në Pejë, duke lutur institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë, të marrin hapa të shpejtë dhe të duhur, që raste të tilla mos të ndodhin më, si dhe kërkoi që presidentja e vendit të shpallë ditën e nesërme, ditë zie për gratë e vrara.

Sa i përket këtij peticioni, tha se i intereson ta di se si qëndrojnë raportet e këtyre grave që janë të nënshkruara në këtë peticion me Bordin e AKP-se, dhe përderisa po thoni se ndaj këtyre personave që kanë vendosur nënshkrimet në peticion, mund të ketë masa nga menaxhmenti i AKP-së, si mendoni se do ta keni komunikimin.

Drita Gjonbalaj, njoftoi se ky bord është emëruar që tri vite dhe tha se shumë herë ka kërkuar që përmes sekretarisë së bordit dhe po ashtu është adresuar edhe me email zyrtar, ku ka shprehur shqetësimet e saj dhe asnjëherë nuk i është dhënë rasti për t'u u shprehur deri në takimin më 24 mars, ku i ka ftuar bordi që të dëgjojë shqetësimet e tyre.

Fatmire Kollçaku, tha se nuk do të donte të dëgjonte se dikush ka frikë të vijë në Kuvend dhe të prezantojë atë çka e mendon, të shprehë fjalën e lirë dhe opinionin e vet, sepse qasja e jonë si institucione është që çdo qytetar ka të drejtë që në organin më të lartë vendimmarrës, sidomos me ftesë, të vijë dhe të prezantoj çfarëdo që është shqetësimi i tij, dhe pastaj janë organet e tjera që do të bien përfundime.

Tha se ne ende duhet të flasim për gra dhe burra, deri në arritjen e asaj barazie që e synojmë, sidomos ky Komision. Po ashtu, theksoi se është Ligji për barazi gjinore, që ka përcaktuar disa kritere, të cilat si shoqëri i synojmë.

Shtoi se këto gjera nuk janë vetëm në AKP, por edhe në institucione të tjera, dhe ne si shoqëri, Kuvend e edhe kjo Qeveri, jemi të interesuar për ta ndryshuar këtë realitet, sepse nëse shikojmë shumë në mënyrë burokratike, pengesat janë aty evidente, por ne jemi aty t'i ndryshojmë së bashku, të krijojmë parakushte dhe mundësi të barabarta, qoftë edhe përmes ndryshimit të legjislacionit.

Drita Gjonbalaj, tha se në AKP, ekziston një diktaturë dhe një dhunë e paparë, një kërcënim ndaj grave, por jo edhe vetëm ndaj tyre.

Marigona Geci, tha se nga ajo që u tha nga përfaqësuesja e petitionit, u kuptua se gjithmonë në AKP, pozitat menaxheriale u jepen burrave dhe kjo ndodh edhe në shumë institucione të tjera, ku kjo përvoja menaxheriale kërkohet prej grave dhe ato nuk mund ta fitojnë këtë përvojë, pa u punësuar në pozita menaxheriale. Pra, femrave duhet t'iu jepet hapësirë më shumë në pozita menaxheriale, për të pasur zbatim të Ligjit për barazi gjinore.

Tha se kishin menduar që do të vijnë edhe të tjera gra nënkruese të këtij peticioni, por nuk paskan guximin, për shkak se ndëshkohen më vonë dhe ky është shqetësim.

Ajo shtoi se shqetësim tjetër është edhe se brenda një jave në Kosovë, janë vlarë dy gra dhe është e papranueshme kjo që po ndodh në vendin tonë, duhet të ketë drejtësi për gratë.

Drita Gjonbalaj, falënderoi anëtarët e Komisionit për përkrahjen dhe durimin që patën për të dëgjuar shqetësimet që paraqiti. Po ashtu, shpreson se shqetësimet që janë të shprehura në peticion, do t'i shfaqni edhe para menaxhmentit dhe Bordit të AKP-së.

Nënkryetarja, tha se në legjislacionin aktual në fuqi, do të duhej të promovohet edhe pozita për gratë në vendet e punës dhe konsideroj se të gjitha institucionet kanë përgjegjësi të ndihmojnë dhe t'i përkrahin gratë në pozita, cilado qofshin ato, e veçanërisht për pozitat e larta, të cilat fatkeqësisht akoma shihen si pozita që u takojnë vetëm burrave.

Si Komision, do të vazhdojmë të merremi me këtë peticion, sepse pas takimit, do të vendosim çfarë hapash do të ndërmarim në vijim, lidhur me këtë peticion, sepse barazia gjinore është çështje e të drejtave të njeriut.

Në fund, ajo shtoi se për këtë do të vendosim në një takim, kur është prezentë edhe kryetarja e Komisionit.

4. Të ndryshme

Nënkryetarja konstatoi se takimi me Komisioni Qeveritar për Persona te Pagjetur, do të mbahet në mbledhjen e rregullt, të martën, më 23 prill, në orën 13:00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda BALJE,

Kryetare e Komisionit